

Parathënia e botimit të tretë

Politika mund të duket diçka efemere, që ndërron bashkë me kohën, por puna përgatitore që na u desh të bënim për këtë botim të ri të Fjalorit Politik, tregon se sa të thella janë themelet mbi të cilat ngrihet studimi i politikës. Jemi përpjekur të pasqyrojmë në këtë botim ndikimin e ngjarjeve bashkëkohore në konceptet dhe institucionet mbi të cilët bazohet kuptimi i politikës, ashtu si dhe zhvillimet që kanë ndodhur në studimin dhe interpretimin e politikës.

Zërat në këtë botim janë shkruar nga një ekip akademikësh, specialistë të fushave që mbulojnë. Ky ekip është zgjeruar, duke qenë se ndërkohë kanë lindur koncepte të reja. I jemi mjaft mirënjohës kontribuuesve të botimit të mëparshëm për përditësimin dhe rishikimin e zërave të tyre, ashtu si dhe pjesëtarëve të rinj të ekipit që bënë të mundur zgjerimin dhe rifreskimin e librit. Duhet të falënderojmë gjithë ata lexues që me sugjerimet dhe komentet që na dërguan, na bënë të kryenim një sërë ndryshimesh duke shtuar mjaft zëra të rinj.

Ndryshimet e ndodhura në politikë janë pasqyruar në zërat e rinj që mbulojnë koncepte të tillë si kozmopolitizmi, përplasja e qytetërimeve, demokraci vendimore, apo politika e frikës. Ndikimi që kanë pasur ndodhitë bashkëkohore dhe meraku ynë për të zgjeruar mbulimin gjeografik, ka sjellë, po ashtu, mjaft zëra të rinj. Po ashtu, ngjarje me një jehonë të gjerë politikë, na bënë të shtojmë zëra të tillë si ata për Ruandën apo Darfurin. Në shumë prej zërave të fjalorit gjen referime për zëra të tjerë, çka shënohet me asterisk.

Kriteret që kemi përdorur për përzgjedhjen e zërave të këtij Fjalori përsa i takon teoricienëve dhe politikanëve mbeten të njëjta me ato të botimit të mëparshëm, që përmenden në parathënien e botimit të vitit 1996. Ndonëse, kontribute të rëndësishme mund të jepen padyshim edhe në të gjallë, kriteri që ne kemi përdorur është të përfshijmë në Fjalor vetëm ato figura që tashmë kanë vdekur.

Ky botim ofron po ashtu lidhjen në web, duke iu referuar website-it të Fjalorit: www.iup.com/ref/uk/reference/resources/politics. I jemi mirënjohës stafit të Oxford University Press për mbështetjen që na kanë dhënë dhe sugjerimet e bëra për risitë që gjenden në këtë botim.

Parathënie

Ky është një fjalor i ri, i shkruar nga një grup politologësh dhe teoricienësh të politikës të Departamentit të Shkencave politike dhe të Studimeve Ndërkombëtare të Universitetit të Warwick-ut, një nga departamentet më në zë në këtë fushë në Mbretërinë e Bashkuar. Shpresojmë që t'u hyjë në punë të gjitha kategorive të lexuesve, por kategoria që kemi pasur më shumë parasysh është ajo e studentit universitar që sapo i ka hyrë studimit të politikës.

'Politika' është një ndër ato fjalë (si për shembull 'gjeografia' dhe 'historia') që përshkruajnë edhe një veprimtari, edhe studimin e kësaj veprimtarie. Ky është fjalor i politikës në kuptimin e dytë, jo në të parin. Me fjalë të tjera, nuk është fjalor që përshkruan ngjarjet, as fjalor i politikanëve, as fjalor i vendeve dhe i rajoneve ku bëhet politikë (domethënë, kudo në botë). Ka shumë fjalorë të tillë, dhe nuk ka kuptim të shtosh numrin e tyre. Ky fjalor trajton konceptet, njerëzit dhe institucionet që përmenden

zakonisht në shkrimet akademike dhe shkencore që kanë të bëjnë me politikën. ‘Konceptet’ dhe ‘institucionet’ pak a shumë kuptohet përse përfshihen. Kurse njerëzit duhet të plotësojnë dy kritere për të hyrë në këtë fjalor. I pari, duhet të kenë dhënë një ndihmesë të shquar në zhvillimin e teorisë së politikës, në projektimin dhe krijimin e institucioneve politike, ose në shkencën e politikës; i dyti, duhet të kenë vdekur para prillit 1994. Kriterin e dytë e kemi zbatuar se nuk duam të hyjmë në diskutime shterpe dhe të pafund se kush janë shkencëtarët dhe teoricienët më të mëdhenj të politikës që janë gjallë. Shkencëtarët dhe teoricienët, vepra e të cilëve duket se do të qëndrojnë, përmenden në përshkrimin e koncepteve ose të institucioneve përkatëse.

Në shqyrtimin e problemit të përfshirjes në fjalor të këtij ose atij politikani, kemi vepruar si vijon: politikani fiton të drejtën e një artikulli më vete në qoftë se ka dhënë ndihmesë në krijimin e ndonjë institucioni të rëndësishëm ose ka nxjerrë ndonjë teori ose ideologji. Në rastin e fundit kemi marrë parasysh edhe ‘-izmin’: politikanët që kanë ndonjë doktrinë ose praktikë që mban emrin e tyre kanë më shumë të ngjarë të përfshihen në fjalor sesa ata që nuk e kanë, zakonisht të zëri i doktrinės ose i praktikës përkatëse. Ndryshe nga Oxford English Dictionary, ky fjalor nuk ka artikuj veçan për majorizmin (nga John Mayor), për arsye se nuk e dimë ç’është. Megjithatë, fjalori ka zë veçan për Thomas Jefferson-in dhe Abraham Lincoln-in – madje Jefferson-i ka dyfish të drejtë të jetë në fjalor, edhe si teoricien i politikës, edhe si krijues institucionesh. Fakti që Jean Monnet-i ka një zë veçan, kurse Winston Churchill-i nuk e ka, nuk do të thotë se mendojmë (ose se nuk mendojmë) se Jean Monnet-i është politikan më i madh se Winston Churchill-i. Sidoqoftë, në fund të librit kemi vënë një shtojcë që jep emrat (dhe partitë, ku duket me vend) e udhëheqësve politikë kryesorë të të gjitha vendeve kryesore anglishtfolëse dhe të vendeve më të rëndësishme të botës. Në shumicën e rasteve listat fillojnë nga viti 1945, por në rastet kur personat përmenden për veprimtari politike të zhvilluar më parë listat shkojnë edhe më prapa në kohë.

Për sa u përket vendeve dhe kohëve, jemi nisur nga politika që mësohet përgjithësisht në universitetet e vendeve anglishtfolëse. Kështu, kemi filluar me Greqinë klasike dhe arrijmë deri në ditët tona. Jemi përpjekur të jemi sa më të gjerë në përfshirjen e institucioneve politike kryesore të botës demokratike, duke u ndaluar më shumë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Hapësira e kufizuar ka bërë që të jemi më të kursyer me pjesën tjetër të botës, sido që jemi përpjekur të jemi sa më të gjerë në drejtim të Kinës dhe të Lindjes së Mesme. Sigurisht, do të na kritikojnë për etnocentrizëm. Përgjigjja jonë është se përpiqemi të plotësojmë kërkesat e atyre që studiojnë lëndën ashtu siç është, dhe jo siç do të donim ne të ishte.

Në parathënien e Fjalorit përmbledhës të sociologjisë, Gordon Marshall-i shkruante se ‘Sociologjia ka bërthamë teorike të qartë, por ajo që është rreth saj është shumë e errët’. Këto fjalë janë po aq të vërteta për politikën dhe, po ashtu si në rastin e sociologjisë, mund të thuhet se ‘një nga të mirat kryesore të lëndës është se lehtëson studimin e problemeve të mirëfillta ndërdisiplinore’. Pikërisht natyra ndërdisiplinore e politikës na tërheq dhe na nxit në studimet tona, por na krijon edhe probleme si hartues dhe redaktorë të fjalorit. Për çështje anësore, kemi bërë pyetjen: ‘A ka të ngjarë që lexuesi që has në këtë term dhe dëshiron të mësojë më shumë rreth tij të marrë në dorë një fjalor të politikës?’ Ka mundësi të na kritikojnë për disa nga vendimet që kemi marrë. Por edhe këtu përgjigjja jonë do të jetë se kemi bërë ç’kemi bërë, dhe nuk kemi bërë ç’nuk kemi bërë. Shpresojmë të paktën të kemi qenë konsekuentë dhe të kemi nxjerrë diçka të dobishme për lexuesin.

Të gjitha zërat, me përjashtim të atyre të shkruara nga Redaktori i Përgjithshëm, kanë siglën përkatëse. Yllthi (*) i vënë para fjalës në një përcaktim tregon se tek ajo fjalë mund të gjendet informacion

plotësues. Disa fjalë-titull e çojnë lexuesin te një fjalë-titull tjetër, qoftë se janë sinonime, qoftë se shpjegohen më mirë, bashkë me termat përkatës, në artikullin më të gjatë të fjalorit.